



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Gllogoc

Udhëheqësi i Personelit

01Nr. 070-836 dt. 04.01 /2019

Bazuar në nenin 12 ,paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Komuna Gllogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit shpallë :

KONKURS PUBLIK
me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Pozitat: e vendit të punës:

koeficienti :

1 Inspektor i ndërtimit

7

1 Inspektor I Mjedisit- Sanitar

7

I. Përshkrimi i vendit të punës :

- Inspektimi i ndërtimit, ku përfshin ngritjen, instalimin, renovimin dhe zgjerimin e ndërtesave;
- Inspektimi ndryshimi, ndërrimi i destinimit dhe rrënimin e çfarëdo ndërtese a strukture;
- Inspektimi i kushteve urbanistike – teknike (pëlqimi urbanistik);
- Inspektimi i dokumentacionit teknik (projektin e ndërtimit, lejet e ndërtimit);
- Inspektimi i lejeve të përdorimit të objekteve (pas përfundimit të fazës së ndërtimit);
- Mbikëqyrja e rrënimin të objekteve të ndërtuara pa leje;
- Nxjerr procesverbale, aktvendime për ndërprerjen e punëve;
- Bën propozim për nxjerrjen e aktvendimit për rrënim dhe konkluzës për lejimin e përmbarrimit të aktvendimit;
- Ushtron fletëparaqitje për shkelje të dispozitave me të cilat bëhet kundërvajtje dhe vepër penale;
- Kryen edhe detyra tjera të parapara me ligj, rregullore dhe akte tjera nënligjore;
- Të raportoj për punën e bërë, raporte periodike, mujore, vjetore, etj.

Qëllimi i vendit të punës: Të gjitha inspektimet në lëminë e inspeksionit të ndërtimit me qëllim të parandalimit të ndërtimeve pa leje, mbrojtja e pronës Komunale dhe shoqërore si dhe zbatimit të planit urbanistik dhe që të arrihet krijimi i rregullit nga lëmia e ndërtimitarisë.

Shkathhtësitë e kërkuar: (kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathhtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës ,
- 3 vjet përvojë pune profesionale,
- Njohuri në fushën e programeve të kompjuterit ;Word, Excel, Power Point, Access,
- Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion,

II. Përshkrimi i vendit të punës :

- Inspektimi i ujrave të zeza sipas kërkeses si dhe ndotësve të ajrit
- Inspektimi i gurëthyesve, zhfrytësimit ilegal të zhavorit
- Marrja e masave për hyrje në sistem të menaxh.mbeturinave
- Marrja e masave për ndotësit e mjedisit.
- Inspektimi i tregjeve, thertoreve etj.
- Kontrollimi i ushqimit dhe higjenes në subjekte afariste ushqimore dhe subjekte hoteliere
- Kontrollimi i Institucione Edukative Arsimore dhe shëndetsore
- Kontroll i pajisjes me libreza sanitare dhe dhënja e pelqimeve sanitare
- Kontroll e përgjithshme për respektim të Ligjit të duhanit.
- Kontrollimi i ujit te pijes
- Zbatimi i masave për pengimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitse
- Shqyrtimi i kërkesave të palës
- Kontrollimi i furrave te bukes.
- Punë dhe detyra tjera sipas urdhrit të Shefit apo Drejtorit

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrimi i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)
Të gjitha inspektimet në lëminë e inspeksionit sanitar me qëllim të mbrojtjes shëndetsore, higjenes dhe shëndetit publik dhe kërkohet që të arrihet plotësimi i kushteve minimale higjenike-sanitare.

Shkathtësitë e kërkuara: (kualifikimet,përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

Diplomë Universitare – Ambient, Kimi, Teknologji Ushqimore
3 vjet përvojë pune profesionale,
Njohuri në fushën e programeve të kompjuterit ;Word, Excel, Power Point, Access,
Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion,

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës,Ligjin Nr.04/L-077,Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **04/01/2019 deri më 11/01/2019**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kohëzgjatja e angazhimeve është 5.5 muaj.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vend pune, për të cilin konkurohet.



U.D.Udhëheqëse e Personelit

Hanumshahe Shabani